



Nr. Prot. **265**

Tiranë, më **1/9/2025**

Kriteret dhe procedurat e pranimit
MASTER I SHKENCAVE NË
“SHKENCAT REHABILITUESE TË PROFESIONEVE SHËNDETËSORE”
Viti akademik 2025- 2026

UDHËZIME ME KARAKTER TË PËRGJITHSHËM

Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" dhe Universiteti i Romës "Tor Vergata" në përputhje me legjislacionin Universitar Shqiptar dhe Italian në fuqi në shtetet përkatëse, çelin për vitin akademik 2025- 2026, *Masterin në "Shkenca Rehabilituese të Profesioneve Shëndetësore" (në Shqipëri Master i Shkencave në "Shkenca Rehabilituese të Profesioneve Shëndetësore")*.

KUOTA NË DISPOZICION DHE KRITERET E PRANIMIT

Për vitin akademik 2025- 2026, në programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Rehabilituese të Profesioneve Shëndetësore" janë të rezervuara **30 kuota** për kandidatët shqiptarë; **40 kuota** për kandidatët nga vendet e BE-së, **1 kuota** për shtetasit e Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi dhe **2 kuota** për kandidatët nga vendet e tjera jo anëtare të BE-së dhe **1 kuotë** për kandidatët me aftësi ndryshe.

Për t'u pranuar në programin e studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Shkenca Rehabilituese të Profesioneve Shëndetësore" kandidatët duhet të jenë të pajisur me një diplomë 3-vjeçare ose titull ekuivalent të lëshuar nga një Universitet i akredituar, e cila kualifikon në ushtrimin e një prej profesioneve të kujdesit shëndetësor të përfshira në kategorinë e diplomës master (Edukator Profesional, Fizioterapist, Logopedist, Ortoptist – Asistent në Olfalmatologji, Podolog, Teknik Rehabilitimi Psikiatrik, Terapist Neurolog dhe Psikomotor i Moshës së Zhvillimit, Terapist Okupacional).

MËNYRA E APLIKIMIT PËR KONKURSIN E PRANIMIT

Për të aplikuar, kandidatët duhet të kryejnë procedurën e regjistrimit online në portalin e Universitetit Katolik ZKM: <http://admissions.unizkm.al/> brenda datës **03 tetor 2025, ora 23:59**, duke bashkëngjitur një kopje elektronike në formatin PDF të dokumentacionit vijues:

- 1- Diploma universitare.
- 2- Vërtetim i listës së notave dhe krediteve të fituara gjatë studimeve universitare të kryera më parë.
- 3- Fotokopje e dokumentit të identifikimit (pasaportë ose kartë identiteti).

Pas ngarkimit të gjithë dokumentacionit të mësipërm, kandidatët e huaj duhet të paguajnë **brenda datës 03 Tetor 2025** tarifën për aplikimin¹ prej 50 Euro si vijon:

- Me transfertë bankare në llogarinë² me këto të dhëna:

¹ Komisionet paguhen nga dërguesi. Tarifat duhet të mbërrijnë të plota në llogarinë bankare të Universitetit, përndryshe regjistrimi është i pavlefshëm.

² Ju lutemi të specifikoni në Urdhërpagesë emrin dhe mbiemrin tuaj si dhe programin e studimit për të cilin po kryeni pagesën. Ditën e intervistës duhet të paraqisni kopje të mandat-pagesës duke qenë se koha e mbërritjes së pagesave është e kufizuar.



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

Përfituesi: Zoja e Këshillit të Mirë (Universiteti Katolik)

Banka: Intesa San Paolo Bank

BIC/Swift: USALALTR

IBAN: AL60208112040000030694935302

- me kartë krediti online në portalin e Universitetit : <https://admissions.unizkm.al/>;
- pranë Zyrës së Pranimeve të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", e disponueshme nga e hëna në të premte, nga ora 08:00-16:30 .

Më pas do të kryhet kontrolli i dokumentave për secilin kandidat. Kandidati mund të verifikojë statusin e tij të aplikimit në profilin e tij online në portalin e Universitetit.

Kandidatët që konsiderohen të kualifikuar pas verifikimit të dokumentacionit, duhet të paguajnë edhe tarifën e pjesëmarrjes në intervistën **brenda datës 08 tetor 2025, ora 16:30:**

- 2,000 lekë për shtetasit shqiptarë dhe shtetasit e Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi;
- 100 euro për kandidatët e tjerë të huaj.

Pagesa do të kryhet me të njëjtat mënyra të përdorura për të paguar tarifën e aplikimit prej 50 Euro.

MËNYRA E PËRZGJEDHJES

Përzgjedhja e kandidatëve në programin e studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në *Shkenca Rehabilituese të Profesioneve Shëndetësore* do të zhvillohet përmes një testimi me shkrim në gjuhën italiane, në formën e një testi shkencor për lëndet profesionale e cila do të zhvillohet në datën **13 Tetor 2025, ora 11:00** në selinë e Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Rruga "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri. Testimi përmban 80 pikë.

Rezultatet e testimit do të publikohen në faqen zyrtare të Universitetit Katolik ZKM: <https://www.unizkm.al/> **brenda datës 17 tetor 2025.**

REGJISTRIMI

Për t'u regjistruar, kandidatët e shpallur fitues duhet të dorëzojnë pranë Sekretarisë Mësimore personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi të pajisur me prokurë noteriale, deri **në datën 27 Tetor 2025** dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Mandatin e kryerjes së pagesës së tarifës vjetore të studimit (urdhërpagesa për t'u paraqitur në bankë, shkarkohet nga portali studenti, zëri "Tariffe");
2. Diplomën dhe listën e notave/suplementin e diplomës, kopje të saj të njehsuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomë të ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me kopje të diplomës të njehsuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njohja dhe njehsimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë. Kandidatët që nuk e kanë përfunduar procesin e njohjes dhe njehsimit të diplomës, paraqesin vërtetimin që kanë aplikuar pranë QSHA për njohje dhe njehsim;
3. Kopjen e dokumentit të identifikimit;
4. Certifikata Ndërkombëtare e Njohurive Gjuhësore në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor" dhe në zbatim të dekreteve në fuqi (nëse kandidati ka detyrimin për ta dorëzuar)
5. Dy fotografi personale;



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

Ne rastet kur dokumentacioni vjen nga një Universitet i huaj, dokumentacioni duhet të jetë i pajisur me vulen apostille të vendit të orgjines.

Në rastet kur dokumentacioni i parashikuar vjen nga një Universitet i huaj dhe nuk është në gjuhën shqipe apo italiane, ai duhet përkthyer në gjuhën shqipe.

Shënim: Ju kujtojmë se shtetasit e huaj mund të qëndrojnë lirisht në Shqipëri për një periudhë maksimale prej 90 ditësh në një gjashtëmujor (gjashtëmujori llogaritet nga dita e parë e hyrjes në vend dhe 90 ditët llogariten duke shtuar të gjitha periudhat e qëndrimit në Shqipëri, edhe nëse jo të pasnjëshme). Ata që synojnë të qëndrojnë në territorin shqiptar për më shumë se 90 ditë në një gjashtëmujor duhet të aplikojnë për leje qëndrimi pranë autoriteteve kompetente shqiptare.

Kandidatët të cilët nuk janë në përputhje me dorëzimin e dokumenteve të lartpërmendura do të regjistrohen me rezervë dhe nuk do të mund t'i nënshtrohen provimeve derisa të disponohet dokumentacioni i kërkuar. Regjistrimi me rezervë do të thotë se mospërmbushja e kërkesave brenda afateve të përcaktuara me dekretet ministrore mund të rezultojë në mosmarrjen e statusit të studentit dhe për rrjedhojë humbjen e çdo të drejte ndaj Universitetit Katolik. **Kandidatët e suksesshëm do të regjistrohen në vitin e parë të kursit me rezerva derisa të marrin numrin matrikullimit nga QSHA.**

Në rastet kur dokumentacioni vjen nga një universitet i huaj, ai duhet të dorëzohet në:

- Sekretarinë Mësimore në kopje të noterizuar.
- QSHA për ekuivalentimin në kopje të noterizuar, apostilluar dhe përkthyer në shqip.

Gjithashtu pranë Sekretarisë Mësimore do të plotësohen:

- Kërkesa e regjistrimit (kërkesa mund të shkarkohet edhe nga portali studenti: portal.unizkm.al);
- Kontrata e regjistrimit.
- Deklaratat sipas Shtojcave nr. 1 dhe nr 2 të Udhëzimit nr.12 të datës 30/06/2023.

Nëse një kandidat i shpallur fitues, nuk kryen regjistrimin brenda afateve të caktuara, e humbet automatikisht të drejtën e regjistrimit. Numri minimal i studentëve të regjistruar, i domosdoshëm për nisjen e programit të studimit, është 30 studentë.



Rektori

Prof. Leonardo Palombi